



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 230, datë 26.04.2024

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES
TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJE PARALELE NË GJYKATËN
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË, PËR POZICIONET E
LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 256, 257 DHE 258 DATË 24.05.2023
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 7, 8 dhe 9 të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e relatorit për këto procedura përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele sipas numrit të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë:
 - a) Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023
-relator z. Alban Toro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR